

Vendim nr. 173 datë 19.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 19.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 20 (Sh) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA TREGTARE “FLEVI” SH.P.K.**, përfaqësuar nga avokati Eno Seferi, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 7382, datë 15.12.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 00-2023-418 (69), datë 16.02.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 43, paragrafi 1, 131, pika 1, shkronja “f”, 132 dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja, shoqëria tregtare “Flevi” sh.p.k., në periudhën gusht - shtator 1999, ka importuar një sasi hekuri, duke kryer edhe zhdoganimin e mallit. Pas një kontrolli doganor aposterior është konstatuar se kërkuesja nuk ka paguar vlerën e plotë të detyrimit doganor të importit, referuar çmimit real të blerjes së mallit. Për këtë shkak, me vendimin nr. 40, datë 14.05.2004 (*vendimi nr. 40/2004*) të Degës së Doganës Tiranë, kërkuesja është ngarkuar me detyrimin doganor të papaguar, përveçse është dënuar edhe me gjobë, ku detyrimi total kapte vlerën 26.622.520 lekë. Ndërsa ky vendim, sipas Kodit Doganor, përbënte titull ekzekutiv, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 24.06.2005, ka lëshuar urdhrin për ekzekutimin e tij.

2. Kërkuesja ka paraqitur padi në gjykatë, duke kërkuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, vendimit nr. 40/2004 të Degës së Doganës Tiranë, me pretendimin se detyrimi doganor ka lindur me datën e pranimit të deklaratave doganore (datë 28.08.1999), ndërsa ajo është njoftuar në datën 18.10.2004, pra jashtë afatit 3-vjeçar të parashikuar nga neni 236 i Kodit Doganor. Për këtë padi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6527, datë 20.11.2006, ka vendosur rrëzimin e saj. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 466, datë 04.03.2008. Në vijim, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 548, datë 03.10.2013, ka ndryshuar vendimet e gjykatave më të ulëta, duke pranuar padinë dhe deklaruar të pavlefshëm titullin ekzekutiv.

3. Në datën 17.09.2014, ndërsa autoritetet doganore kishin vjelur detyrimin sipas titullit ekzekutiv, që më pas u deklarua i pavlefshëm me vendim gjyqësor përfundimtar, përmes një padie për begatimin pa shkak, kërkuesja ka kërkuar ndaj të paditurve, Degës së Doganës Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, kthimin e shumës 26.966.520 lekë, si dhe pagimin e kamatave të arrira të kësaj shume nga data 01.01.2007 dhe deri në ditën e përmbushjes së detyrimit.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 7382, datë 15.12.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke detyruar solidarisht të paditurit për t'i kthyer paditëses (kërkueses) shumën 26.966.520 lekë, ndërsa ka rrëzuar padinë në lidhje me kamatat e arrira. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka ushtruar ankim.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2700, datë 15.12.2015, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar tërësisht padinë dhe urdhëruar detyrimin e të paditurve për t'i kthyer kërkueses shumën 26.622.520 lekë, si dhe interesin për këtë shumë, sipas interesit të aplikuar nga bankat e nivelit të dytë, për periudhën nga data e vjeljes së këtij

detyrimi nga të paditurit e deri në ekzekutimin e vendimit. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs të paditurit dhe Avokatura e Shtetit.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-418 (69), datë 16.02.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

7. Në datën 29.05.2024 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 04.06.2024.

II

Pretendimet e kërkeses

8. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar *të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, pasi Gjykata e Lartë ka kaluar kufijtë e shqyrtimit të rekursit sipas nenit 473/a të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), ndërsa ka vënë në diskutim çështje të ligjit për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendim. Pretendimet në rekursin e të paditurve janë të përgjithshme, ndërsa kundërshtohet detyrimi për kthimin e shumës së paguar për efekt të vendimit të Degës së Doganës Tiranë, por nuk janë ngritur shkaqe ligjore për sa i përket detyrimit për pagimin e interesave të njohura nga gjykata e apelit, prandaj kjo çështje e fundit nuk mund të merrej në shqyrtim kryesisht nga Gjykata e Lartë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkeses

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të

shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Kërkuësja, si person juridik i së drejtës private, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

11. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Kolegji vëren se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 16.02.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 29.05.2024. Në përgjigje të kërkesës, Gjykata e Lartë ka informuar se vendimi i arsyetuar është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 12.02.2024. Në këto rrethana, Kolegji çmon se kërkuësja legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

13. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuësja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka vënë në diskutim çështje të ligjit, për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendim dhe ndonëse në rekurse nuk janë ngritur pretendime në lidhje me mosnjohjen e interesave për shumën e paguar, ajo gjykatë i ka marrë në shqyrtim kryesisht. Ndonëse këtë pretendim kërkuësja nuk e ka lidhur me cenimin e ndonjë të drejte ose parimi kushtetues konkret, nisur nga thelbi dhe natyra e tij, Kolegji vlerëson ta trajtojë në këndvështrim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit

14. Kërkuesja ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi Gjykata e Lartë ka kaluar kufijtë e shqyrtimit të rekursit sipas nenit 473/a të KPC-së, ndërsa ka vënë në diskutim çështje të ligjit, për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendim. Pretendimet në rekursin e të paditurve, sipas kërkueses, janë të përgjithshme, ndërsa kundërshtohet detyrimi për kthimin e shumës së paguar për efekt të vendimit të Degës së Doganës Tiranë, por nuk janë ngritur shkaqe ligjore për sa i përket detyrimit për pagimin e interesave të njohura nga gjykata e apelit, prandaj kjo çështje e fundit nuk mund të merrej në shqyrtim kryesisht nga Gjykata e Lartë.

15. E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në sensin material karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 3, datë 07.02.2023; nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 27, datë 24.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Kolegji evidenton se kërkuesja i është drejtuar gjykatave për kthimin e shumës dhe pagimin e interesave bankare në lidhje me detyrimin doganor të paguar prej saj, i cili është deklaruar i pavlefshëm me vendim përfundimtar të Gjykatës së Lartë.

18. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar të paditurit t'i kthejnë kërkueses shumën prej 26.966.520 lekësh për shkak të deklarimit të pavlefshëm të titullit ekzekutiv, vendimit të Degës së Doganës Tiranë. Kjo gjykatë ka arsyetuar se në kushtet kur titulli ekzekutiv është deklaruar i pavlefshëm, detyrimi i vjelur nga pala e paditur është në kundërshtim me nenin 236 të Kodit Doganor, ndaj ajo duhet të kthejë

shumën e paguar nga kërkuesja në kuadër të ekzekutimit të atij titulli. Ndërsa për sa i përket pagimit të kamatave në lidhje me këtë shumë, gjykata e shkallës së parë i është referuar parashikimit të Kodit Civil (KC), sipas të cilit shpërblimi për dëmin e shkaktuar si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume parash, përbëhet nga kamatat e arrira, prej datës së fillimit të vonesës së debitorit. Sipas gjykatës, kërkimi i kamatave nuk mund të bëhet nga momenti i vjeljes së detyrimit, pasi ky i fundit konsiderohej i ligjshëm derisa Gjykata e Lartë është shprehur me vendim që ky shkak është i paligjshëm. Kështu, në kohën që kërkuesja ka përmbushur këtë detyrim nuk ka pasur asnjë detyrim ose marrëdhënie detyrimi të lindur mes palëve ndërgjyqëse për llogari të të cilit të fillojnë dhe të ecin kamatat e arrira. Pra, shprehet gjykata, nuk mund të pranohet ligjërisht se pala e paditur ka qenë në vonesë në përmbushjen e ndonjë detyrimi në favor të palës paditëse, për rrjedhojë nuk gjen vend koncepti i kamatës së arrirë (*shih faqet 4-5 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

19. Mbi ankimin e kërkueses, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pranimin e padisë dhe detyrimin e të paditurve t'i kthejnë kërkueses shumën e paguar, si dhe interesin për këtë shumë, nga data e vjeljes së detyrimit e deri në ekzekutimin e vendimit. Kjo gjykatë ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë ka çmuar drejt për sa i përket kërkimit të parë në padi për kthimin e shumës së detyrimit, pasi titulli ekzekutiv është deklaruar i pavlefshëm nga gjykata me vendim të formës së prerë, për rrjedhojë shuma e vjelë nëpërmjet ekzekutimit të tij duhet t'i kthehet kërkueses. Në lidhje me kërkimin tjetër në padi, që lidhet me pagimin e kamatave, kjo gjykatë ka vlerësuar se ai duhet të pranohet për sa kohë pala e paditur ka marrë nga paditësi shumën 26.966.520 lekë mbi bazën e një akti, i cili, më pas, me vendim gjyqësor, është deklaruar i pavlefshëm për shkak se detyrimi doganor nuk ekziston në kushtet kur nuk është kërkuar brenda afatit 3-vjeçar të parashikuar në nenin 236 të Kodit Doganor. Për pasojë, pala e paditur duhet t'i paguajë paditësit edhe interesat për këtë shumë që nga dita që ky detyrim është vjelë dhe deri në ekzekutim të këtij vendimi gjyqësor, duke u referuar edhe në nenin 450 të KC-së (*shih faqet 6-8 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

20. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs i padituri, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe rrëzimin e padisë në tërësi, duke pretenduar, ndër të tjera, se pasojat janë krijuar nga vendimi administrativ për vendosjen e detyrimit doganor, të cilin kërkuesja nuk e ka kontestuar asnjëherë dhe për të cilin gjykatat nuk janë shprehur. Sipas të paditurit, Gjykata e Lartë, në vitin 2013, në dispozitivin e vendimit ka deklaruar të pavlefshëm titullin ekzekutiv (vendimin nr. 40/2004 të Degës së Doganës

Tiranë), por nuk është shprehur për rregullim pasojash ose kthim shume, ndërkohë që nuk ka asnjë vendim gjyqësor që të ketë përcaktuar shumën që kërkohet të kthehet, përveçse Kodi Doganor e ka të mirëpërcaktuar rrugën për kthimin e shumës ose rimbursimin. Gjykatat, sipas tij, kanë keqinterpretuar dhe keqkuptuar atë që ka vendosur Gjykata e Lartë, ndërkohë që gjykata e apelit nuk ka përcaktuar saktë as shumën e interesave që palët e paditura duhet të paguajnë.

21. Po kështu, kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs edhe i padituri, Drejtoria e Doganës Tiranë. Edhe ai ka kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe rrëzimin e padisë në tërësi, duke pretenduar se vendimi nr. 40/2004 është një akt i mbështetur në ligj dhe detyrimi i përcaktuar në të është ekzekutuar, prandaj kjo çështje konsiderohet e kapërcyer.

22. Gjithashtu, rekurs ka ushtruar edhe Avokatura e Shtetit, e cila edhe ajo ka kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe rrëzimin e padisë në tërësi, duke pretenduar se shkak ligjor i padisë nuk qëndron, pasi në respektim të drejtë të nenit 658 të KC-së, padia e begatimit pa shkak nuk mund të ngrihet kur i dëmtuari mund të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit të pësuar ose padi të një lloji tjetër për të kërkuar kthimin e shumës së paguar të detyrimit doganor dhe gjobës përkatëse. Në gjykimin e mëparshëm, sipas saj, nuk është kërkuar zgjidhja e pasojave të pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv dhe Gjykata e Lartë nuk është shprehur në këtë drejtim.

23. Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Në arsyetimin e vendimit, ajo gjykatë, fillimisht, ka vërejtur se çështjet ligjore të shtruara në rastin në shqyrtim nuk janë të panjohura për palët ndërgjyqëse, ndërsa ato kanë qenë pjesë integrale e debatit gjyqësor midis tyre. Në vijim, ajo ka vërejtur se të dyja gjykatat më të ulëta kanë qëndrim të njëjtë për faktet e mosmarrëveshjes mes palëve, si dhe për sa i përket vlerësimit ligjor në lidhje me detyrimin e organeve publike për kthimin e shumës së detyrimit të paguar, duke pasur ato qëndrim të ndryshëm për sa i përket pretendimit të kërkueses për detyrimin në lidhje me pagimin e interesit për këtë shumë (*shih paragrafët 18-19 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

24. Në lidhje me pretendimin e kërkueses për kamatat e arrira, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se vlerësimi ligjor për faktet nga gjykata administrative e shkallës së parë është i mbështetur dhe në zbatimin korrekt të ligjit, ndërsa gjendet i gabuar vlerësimi ligjor i Gjykatës Administrative të Apelit. Sipas saj, kërkitimi në padi për pagimin e kamatave të arrira nga data 1 janar 2006 nuk gjente mbështetje në ligj, pasi nuk evidentohet lindja në këtë datë e detyrimit të organit publik për kthimin e shumës. Vendimi i Gjykatës së Lartë që ka legjitimuar kërkuesen në kërkitimin për kthimin e shumës mban datën 03.10.2013, prandaj për periudhën 2006 - 2013 nuk mund të konstatohet asnjë

dëm efektiv ose i prezumuar ndaj organit publik, i cili nuk ka qenë në vonesë kundrejt kërkueses për sa kohë në atë vendim, në pikëpamje deklarative, Gjykata e Lartë nuk ka urdhëruar gjyqësisht palën e paditur për pagimin e ndonjë shume. Po kështu, sipas asaj gjykate, ekzekutimi i detyrimit doganor është detyrim *ipso lege*, ndërkohë që veprimtaria e organeve administrative ushtrohet në përputhje me parimin e ligjshmërisë, çka do të thotë se shfuqizimi i një akti administrativ nga ana e gjykatës nuk mund të ngarkojë organin publik me detyrimin për të dëmshpërblyer palën në procedurën administrative me shumën e kamatave të arrira për pagimin e padetyruar të një detyrimi, pasi në kohën e nisjes së procedurës administrative organi publik prezumohet në mirëbesim dhe në ushtrim të funksioneve të tij ligjore për mbledhjen e detyrimeve doganore. Sipas Gjykatës së Lartë, vetëm në rastin kur autoritetet gjyqësore pranojnë ankesën kundër vendimeve të autoriteteve doganore për pagimin e detyrimit doganor, këto të fundit duhet t'i kthejnë apeluesit shumën e paguar, kthim i cili mund të bëhet vetëm pasi vendimi gjyqësor, që mbart një detyrim konkret, merr formë të prerë (*shih paragrafët 22-23 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

25. Për sa i përket procedurës së shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, ligjvënësi ka parashikuar disa kërkesa specifike në nenin 473/a, paragrafi 2, të KPC-së, i cili është i zbatueshëm në gjykimin administrativ, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Sipas kësaj dispozite, Gjykata e Lartë shqyrton rekursin brenda kufijve të tij, përveç kur ligji parashikon ndryshe (pika 1). Kur ajo vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit të rekursit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtresave të tyre për çështjet e ligjit (pika 2).

26. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se, sikundër edhe Gjykata e Lartë ka evidentuar, çështjet ligjore të shtruara në rastin në shqyrtim kanë qenë të njohura për palët ndërgjyqëse, ndërsa ato kanë qenë pjesë integrale e debatit gjyqësor midis tyre. Po kështu, Kolegji vëren se, sikundër edhe Gjykata e Lartë ka evidentuar, gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrim të njëjtë për faktet e mosmarrëveshjes dhe për sa i përket vlerësimit ligjor në lidhje me detyrimin e organeve publike për kthimin e shumës së detyrimit të paguar, duke pasur ato qëndrim të ndryshëm vetëm për sa i përket vlerësimit ligjor në lidhje me detyrimin për kamatat e arrira për detyrimin kryesor. Pra, kjo e fundit, jo vetëm që ka qenë një prej kërkimeve të padisë, por palët kanë pasur mundësi dhe janë shprehur qoftë për faktet në themel të këtij kërkimi, ashtu edhe për zbatimin e ligjit për këtë aspekt të mosmarrëveshjes mes tyre. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se

Gjykata e Lartë nuk ka vënë kryesisht në diskutim ndonjë çështje të ligjit, për të cilën palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre.

27. Për sa i përket respektimit të kufijve të shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, referuar përmbajtjes së rekurseve në rastin konkret, Kolegji vëren se të paditurit dhe Avokatura e Shtetit përmes rekurseve të tyre kanë kërkuar rrëzimin e padisë së kërkueses në tërësi, pra jo vetëm për detyrimin kryesor, por edhe për kamatat e arrira. Po kështu, Kolegji vëren se ndonëse në rekursin e tyre të paditurit nuk kanë parashtruar veçmas pretendime për disponimin e gjykatës së apelit për kamatat për detyrimin kryesor, në thelb, përmes pretendimeve të parashtruara ata kanë kundërshtuar ekzistencën jo vetëm të këtij të fundit, por edhe të detyrimit për kamatat e arrira. Kolegji, gjithashtu, vëren se pretendimet në rekurs të të paditurve për mungesën e një detyrimi të shprehur për ato në vendimin e mëparshëm gjyqësor, ashtu dhe për ndjekjen e procedurës së vjeljes së detyrimit bazuar në një titull ekzekutiv, pasojat e prodhuara nga i cili kanë qenë të ligjshme deri në deklarin e tij të pavlefshëm me vendim gjyqësor përfundimtar, duket se janë marrë në konsideratë nga Gjykata e Lartë për arritjen në përfundimet e saj në lidhje me vlerësimin ligjor të bërë nga gjykatat më të ulëta për sa i përket kërimit të padisë për kamatat e arrira. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë ka respektuar kufijtë e shqyrtimit të rekursit.

28. Bazuar në këtë analizë, Kolegji çmon se nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë tejkalluar shkaqet e rekursit ose të ketë verifikuar çështje ligjore për herë të parë dhe me nismë të saj. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, është haptazi i pabazuar.

29. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.